**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr.1788/4 prot.                                                                 Pogradec, më 19.03.2026

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj.MANJOLA KAMOLLI  KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar zonja Kryetare,**

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues, për:

*"Miratimin e Tavaneve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec".*

Me respekt,

**K R Y E T A R**

**Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 7

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr. ______Prot. Pogradec, më ____. ____. 2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. _________ datë __________2026

# "MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE BUXHETORE PËR VITET 2027-2029"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", shkronjës "c", dhe nënpika pika 1.3, shkronja "c", nenit 34 pika 6, nenit 40, neni 41, pika 1 dhe 2 shkronja "d", nenit 54, shkronja "dh" dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar ; Ligjit 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" i ndryshuar , Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Ligjit nr.87/2025 dt 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.128 datë 22.12.2025 "Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026" , Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore", Udhëzim nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029", Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e Tavaneve përgatitore Buxhetore 2027-2029 sipas tabelave bashkëngjitur "Tabela PBA2-Parashikimi i të Ardhurave" dhe "Tabela D1 Tavanet Buxhetore" dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, të gjitha ndërmarjet në varësi të Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**K R Y E T A R E**
**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr.1088/14 prot. Pogradec, më 18.03.2026

# RELACION

Përcaktimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA për vitet 2027-2029 është realizuar në mbështetje të shkronjës "c", pika 1.3, të nenit 9 , nenit 34 pika 6, nenit 40, neni 41, pika 1 dhe 2 shkronja "d", nenit 54, shkronjes "dh", dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" i ndryshuar , Ligjit nr.9936 date 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar ;Ligji nr.87/2025 dt 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.128 datë 22.12.2025"Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026" , Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore", Udhëzim nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029".

Në bazë të udhëzimit nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029", burimet e financimit për PBA 2027-2029,përbëhen nga:

1.Të ardhurat e veta;

2.Transferta e pakushtëzuar ;

3.Transferta e kushtëzuar.

Bazuar në të dhënat financiare,buxheti total i planifikuar për secilin vit është si më poshtë:

| | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|
| **Të ardhurat nga burimet e veta** | 808,483,031 | 810,127,688 | 811,780,043 |
| **Transferta e pakushtëzuar** | 650,655,000 | 674,619,000 | 697,540,000 |
| **Transferta specifike** | 357,710,875 | 357,710,875 | 361,287,981 |
| **Total** | **1,816,848,906** | **1,842,457,563** | **1,870,608,024** |

- 2027:1,816,848,906 lekë
- 2028:1,842,457,563 lekë

- 2029:1,870,608,024 lekë

Më poshtë po bëjmë një analizë më të detajuar sipas llogarive(paga dhe sigurime shoqërore ,shpenzime të tjera korrente,shpenzime kapitale).

| | **2027** | **2028** | **2029** |
|---|---|---|---|
| **Paga dhe Sigurime** | 912,922,871 | 912,922,871 | 924,188,000 |
| **Shpenzime të tjera korrente** | 596,383,034 | 596,383,034 | 609,800,024 |
| **Shpenzime kapitale** | 307,543,001 | 333,151,658 | 336,620,000 |
| **Total** | **1,816,848,906** | **1,842,457,563** | **1,870,608,024** |

- Paga dhe sigurime, përbëjnë një pjesë të madhe të buxhetit dhe kanë një rritje graduale për të mbuluar pagat dhe kontributet e sigurimeve për punonjësit.
- Shpenzimet korrente, rriten ndjeshëm për të mbuluar kostot e shërbimeve publike,shpenzimeve administrative dhe të mirëmbajtjes.
- Shpenzimet kapitale,janë gjithashtu në rritje e cila tregon një angazhim për projekte të reja të infrastrukturës.

Në përgjithësi,buxheti për Bashkinë Pogradec për vitet 2027-2029 reflekton një rritje të qëndrueshme dhe prioritete të qarta për zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor.

**Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për Bashkitë dhe Qarqet, konkretisht për Bashkinë Pogradec, për periudhën 2027-2029 paraqitet si më poshtë:**

*(Në mijë lekë)*

| Bashkia | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|
| Bashkia Pogradec | 629,419 | 650,655 | 674,619 | 697,540 |

Konceptoi: Danjela Hafësllari

Pranoi: Irsa Karapança

Miratoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR**
**Ilir XHAKOLLI**

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 136 - Bashkia Pogradec

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | Burimet Buxhetore | 2024 Fakti | 2025 Fakti | 2026 Plani Fillestar | 2026 Plani i Rishikuar | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029 Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | 412,567 | 433,362 | 737,686 | 737,686 | 740,783 | 742,428 | 744,080 |
| **1.1** | **TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME** | 80,493 | 86,778 | 86,253 | 86,253 | 88,031 | 88,451 | 88,873 |
| 1.1.1 | Taksa mbi Ndërtesën | 73,333 | 78,579 | 78,000 | 78,000 | 79,752 | 80,150 | 80,551 |
| 1.1.2 | Taksa mbi tokën bujqësore | 2,778 | 3,074 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 |
| 1.1.3 | Taksa mbi truallin | 4,382 | 5,126 | 5,253 | 5,253 | 5,279 | 5,301 | 5,322 |
| 1.1.4 | Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **1.2** | **TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA** | 34,731 | 41,971 | 330,000 | 330,000 | 330,000 | 330,000 | 330,000 |
| 1.2.1 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 34,731 | 41,971 | 330,000 | 330,000 | 330,000 | 330,000 | 330,000 |
| **1.3** | **TAKSA TË TJERA VENDORE** | 17,613 | 15,437 | 17,200 | 17,200 | 17,400 | 17,500 | 17,600 |
| 1.3.1 | Taksa vendore mbi biznesin e vogël | 677 | 452 | 400 | 400 | 600 | 700 | 800 |
| 1.3.2 | Taksa vendore në shërbimin hotelier | 8,985 | 8,652 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 |
| 1.3.3 | Taksa e tabelës | 7,951 | 6,333 | 7,800 | 7,800 | 7,800 | 7,800 | 7,800 |
| 1.3.4 | Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen... | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.3.5 | Taksa e përkohëshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **1.4** | **TARIFA VENDORE** | 261,114 | 271,438 | 276,233 | 276,233 | 277,352 | 278,477 | 279,607 |
| 1.4.1 | Tarifa e menaxhimit të mbetjeve | 111,631 | 116,703 | 122,720 | 122,720 | 123,334 | 123,950 | 124,570 |
| 1.4.2 | Tarifa për zënien e hapësirës publike | 13,806 | 13,912 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 |
| 1.4.3 | Tarifa për ndriçimin publik | 36,947 | 31,029 | 32,723 | 32,723 | 32,887 | 33,051 | 33,216 |
| 1.4.4 | Tarifa për gjelbërimin | 55,520 | 57,072 | 58,360 | 58,360 | 58,652 | 58,945 | 59,240 |
| 1.4.5 | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | 1,697 | 1,211 | 1,700 | 1,700 | 1,700 | 1,700 | 1,700 |

Zyrtari i të Ardhurave: **ANXHELA PILINÇI** Koordinator i GMS: **PASKALINO ZIKO** Kryetari i GMS: **DRITAN BABASULI**

**Raporti:** **PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 136 - Bashkia Pogradec

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | Burimet Buxhetore | 2024 Fakti | 2025 Fakti | 2026 Plani Fillestar | 2026 Plani i Rishikuar | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029 Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.6 | Tarifa të institucioneve të arsimit | 7,858 | 8,725 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 |
| 1.4.7 | Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.8 | Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.9 | Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.10 | Tarifa e përkohëshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.11 | Tarifa e parkimit | 546 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.4.12 | Tarifa të tjera | 33,109 | 42,787 | 36,730 | 36,730 | 36,780 | 36,830 | 36,881 |
| **1.5** | **TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK** | 17,640 | 13,402 | 24,000 | 24,000 | 24,000 | 24,000 | 24,000 |
| 1.5.1 | Të ardhura nga ndërmarrjet publike | 2,569 | 2,659 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 |
| 1.5.2 | Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë | 9,299 | 10,743 | 21,000 | 21,000 | 21,000 | 21,000 | 21,000 |
| 1.5.3 | Të ardhura nga partneriteti publik privat | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.4 | Shitja e mallrave dhe shërbimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.5 | Shitja e aseteve financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.6 | Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme | 5,772 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.5.7 | Të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **1.6** | **TË TJERA ADMINISTRATIVE** | 976 | 4,335 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 |
| 1.6.1 | Kamatëvonesat | 276 | 335 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.6.2 | Gjoba, sekuestrime dhe zhvdëmtime | 700 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 |
| 1.6.3 | Të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **2** | **TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR** | 1,870,393 | 994,846 | 980,116 | 980,116 | 1,008,366 | 1,032,330 | 1,058,828 |

Zyrtari i të Ardhurave: **ANXHELA PILINÇI** Koordinator i GMS: **PASKALINO ZIKO** Kryetari i GMS: **DRITAN BABASULI**

*Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).*

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 136 - Bashkia Pogradec

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | Burimet Buxhetore | 2024 Fakti | 2025 Fakti | 2026 Plani Fillestar | 2026 Plani i Rishikuar | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029 Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.1** | **TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME** | 570,155 | 664,276 | 629,419 | 629,419 | 650,655 | 674,619 | 697,540 |
| 2.1.1 | Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme | 570,155 | 507,305 | 530,931 | 530,931 | 552,167 | 576,131 | 599,052 |
| 2.1.2 | Rritja e nivelit të pagave | 0 | 72,646 | 98,488 | 98,488 | 98,488 | 98,488 | 98,488 |
| 2.1.3 | Fond shtesë nga Kuvendi | 0 | 84,326 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **2.2** | **TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE** | 242,626 | 330,571 | 350,697 | 350,697 | 357,711 | 357,711 | 361,288 |
| 2.2.1 | Konviktet e arsimit parauniversitar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.2.2 | Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor | 165,502 | 201,019 | 216,188 | 216,188 | 220,512 | 220,512 | 222,717 |
| 2.2.3 | Arsimi parashkollor – Për stafin mbështetës | 0 | 9,475 | 12,004 | 12,004 | 12,244 | 12,244 | 12,366 |
| 2.2.4 | Arsimi parauniversitar | 11,703 | 12,170 | 15,103 | 15,103 | 15,405 | 15,405 | 15,559 |
| 2.2.5 | Mbrojtja nga zjarri | 20,850 | 34,867 | 35,521 | 35,521 | 36,232 | 36,232 | 36,594 |
| 2.2.6 | Mbrojtja sociale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.2.7 | Administrimi i pyjeve | 11,011 | 20,102 | 22,180 | 22,180 | 22,623 | 22,623 | 22,849 |
| 2.2.8 | Rrugët | 23,396 | 25,989 | 26,776 | 26,776 | 27,312 | 27,312 | 27,585 |
| 2.2.9 | Ujitja dhe Kullimi | 10,164 | 12,544 | 13,425 | 13,425 | 13,693 | 13,693 | 13,830 |
| 2.2.10 | Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti" | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.2.11 | Menaxhimi i mbetjeve urbane | 0 | 10,000 | 9,500 | 9,500 | 9,690 | 9,690 | 9,787 |
| 2.2.12 | Të tjera | 0 | 4,404 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **2.3** | **TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA** | 1,057,611 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.3.1 | Për funksione të deleguara | 1,057,611 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.3.2 | Për projekte të veçanta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Zyrtari i të Ardhurave: **ANXHELA PILINÇI** Koordinator i GMS: **PASKALINO ZIKO** Kryetari i GMS: **DRITAN BABASULI**

*Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).*

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 136 - Bashkia Pogradec

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | Burimet Buxhetore | 2024 Fakti | 2025 Fakti | 2026 Plani Fillestar | 2026 Plani i Rishikuar | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029 Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.4** | **TRANSFERTË SPECIFIKE** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2.4.1 | Transfertë specifike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **3** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA** | 60,777 | 63,130 | 67,700 | 67,700 | 67,700 | 67,700 | 67,700 |
| 3.1 | Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura | 30,250 | 33,491 | 33,000 | 33,000 | 33,000 | 33,000 | 33,000 |
| 3.2 | Renta minerare | 218 | 185 | 200 | 200 | 200 | 200 | 200 |
| 3.3 | Tatimi mbi të ardhurat personale | 27,323 | 24,284 | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 30,000 |
| 3.4 | Të tjera | 2,985 | 5,170 | 4,500 | 4,500 | 4,500 | 4,500 | 4,500 |
| **4** | **GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA** | 434 | 31,977 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **4.1** | **TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4.1.1 | Transferta nga i njëjti nivel qeverisje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **4.2** | **GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME** | 0 | 14,906 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4.2.1 | Grante të Tjera të Brendshme | 0 | 14,906 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **4.3** | **GRANTE TË HUAJA** | 434 | 17,070 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4.3.1 | Grante të huaja | 434 | 17,070 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **5** | **HUAMARRJA** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5.1 | Huamarrja afatshkurtër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5.2 | Huamarrja afatgjatë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **6** | **TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR** | 88,512 | 126,810 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6.1 | Trashëgimi pa destinacion | 65,159 | 92,811 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6.2 | Trashëgimi me destinacion | 23,353 | 33,999 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Zyrtari i të Ardhurave: **ANXHELA PILINÇI** Koordinator i GMS: **PASKALINO ZIKO** Kryetari i GMS: **DRITAN BABASULI**

*Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).*

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 136 - Bashkia Pogradec

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | Burimet Buxhetore | 2024 Fakti | 2025 Fakti | 2026 Plani Fillestar | 2026 Plani i Rishikuar | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029 Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV | | 2,432,682 | 1,650,124 | 1,785,502 | 1,785,502 | 1,816,849 | 1,842,458 | 1,870,608 |

Zyrtari i të Ardhurave: **ANXHELA PILINÇI** Koordinator i GMS: **PASKALINO ZIKO** Kryetari i GMS: **DRITAN BABASULI**

# (D1) TAVANET

| | | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti t+1 (I pritur) | Viti t+2 (I pritur) | Viti t+3 (I pritur) |
| 01110 | Planifikimi Menxhimi dhe Administrimi | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 375,500 | 375,500 | 386,765 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 218,593 | 218,593 | 225,150 |
| | Shpenzimet kapitale | 98,633 | 124,242 | 125,900 |
| Tavanet e përgjithshme | | 692,726 | 718,335 | 737,815 |
| 03140 | Shërbimet e Policisë Vendore | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 03280 | Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 30,000 | 30,000 | 30,000 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 5,521 | 5,521 | 5,521 |
| | Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | | 35,521 | 35,521 | 35,521 |
| 04130 | Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 04220 | Shërbimet Bujqësore,Inspektimi,Siguria Ushqimore&Mbrojtja Konsumatore | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 04240 | Menaxhimi i Infrastruktuës së Ujitjes dhe Kullimit | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 7,586 | 7,586 | 7,586 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 5,839 | 5,839 | 5,839 |
| | Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | | 13,425 | 13,425 | 13,425 |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | 7,000 | 7,000 | 7,000 |
| | Shpenzimet kapitale | 15,180 | 15,180 | 15,180 |
| Tavanet e përgjithshme | | 22,180 | 22,180 | 22,180 |
| 04520 | Rrjeti Rrugor Rural | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 44,112 | 44,112 | 44,112 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 23,530 | 23,530 | 23,530 |
| | Shpenzimet kapitale | 158,600 | 158,600 | 159,740 |
| Tavanet e përgjithshme | | 226,242 | 226,242 | 227,382 |
| 04570 | Transporti Publik | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 05100 | Menaxhimi i i mbetjeve | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | 30,000 | 30,000 | 30,000 |
| | Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | | 30,000 | 30,000 | 30,000 |
| 06140 | Planifikimi Urban Vendor | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 06260 | Shërbimet Publike Vendore | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 138,430 | 138,430 | 138,430 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 228,660 | 228,660 | 235,520 |
| | Shpenzimet kapitale | 22,130 | 22,130 | 22,800 |
| Tavanet e përgjithshme | | 389,220 | 389,220 | 396,750 |
| 06370 | Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| 07220 | Shërbimet e kujdesit parësor | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| | Të tjera shpenzime korrente | | | |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 08130 Sport dhe Argëtim | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | | |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | |
| 08220 Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | | |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | |
| 09120 Arsimi bazë dhe parashkollor | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 288,192 | 288,192 | 288,192 |
| Të tjera shpenzime korrente | 72,944 | 72,944 | 72,944 |
| Shpenzimet kapitale | 13,000 | 13,000 | 13,000 |
| Tavanet e përgjithshme | 374,136 | 374,136 | 374,136 |
| 09230 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 15,103 | 15,103 | 15,103 |
| Të tjera shpenzime korrente | | | |
| Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | 15,103 | 15,103 | 15,103 |
| 10430 Përkujdesi Social | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 14,000 | 14,000 | 14,000 |
| Të tjera shpenzime korrente | 4,296 | 4,296 | 4,296 |
| Shpenzimet kapitale | | | |
| Tavanet e përgjithshme | 18,296 | 18,296 | 18,296 |
| 10661 Strehimi social | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | | |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | |
| | | | |
| TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE | 912,923 | 912,923 | 924,188 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE | 596,383 | 596,383 | 609,800 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE | 307,543 | 333,152 | 336,620 |
| TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME | 1,816,849 | 1,842,458 | 1,870,608 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| MAKSIMUMI I TAVANIT | 1,816,849 | 1,842,458 | 1,870,608 |
| FONDI REZERVE NË PËRQINDJE (%) | 0.06% | 0.07% | 0.08% |
| FONDI REZERVE: 04910 | 1,000 | 1,300 | 1,500 |
| FONDI KONTINGJENCËS NË PËRQINDJE (%) | 0.06% | 0.07% | 0.08% |
| FONDI KONTINGJENCËS: 04940 | 1,000 | 1,300 | 1,500 |
| TOTALI FONDEVE NË PËRQINDJE (%) | 0.12% | 0.14% | 0.16% |
| TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË | 2,000 | 2,600 | 3,000 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. 1288/Prot
/4

Pogradec, më 19.03.2026

**RELACION**

**MBI PROJEKT-VENDIMIN**
**PËR**

**"MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE BUXHETORE PËR VITET 2027-2029"**

***Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:***
***Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:***

1) Akte administrative me karakter normativ
2)Akte administrative me karakter individual
3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar: "*Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.*"

Po kështu, në Ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: *"Akt me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, permes së cilës shprehet vullneti I këtyre organeve, nëushtrimin e funksionit të tyre publik, që I drejtohen subjekteve të papërcaktuar atë së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që I shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".*

Më tej, ky ligj në Nenin 8 shkronja "a" përcakton se :"është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Proçedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, qërregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është I shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Proçedurës Administrative jep këtë perkufizim për "aktin administrativ":

**a)** "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

**b)** "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përmban rregulla të përgjithshme , që zbatohen për një numër të pacaktuar subjektesh dhe për situata abstrakte, duke prodhuar efekte juridike të vazhdueshme . Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në Nenin 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij . Ky projekt-vendim përcakton tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA dhe nivelin e buxhetit të planifikuar për secilin vit të periudhës 2027-2029.

***Përfundimisht konkludojmë se***: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Konceptoi: *N. NAUN*

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com